



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 1533/3 Prot.

Tiranë, më 15.11.2017

**V E N D I M**

Nr. 235, datë 15/11/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 66, datë 30.03.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017", në Bashkinë Mat"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 66, datë 30.03.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017", në Bashkinë Mat,

**VËREJ SE:**

Me Vendimin Nr. 178, datë 27.07.2017, "Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 66, datë 30.03.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar kontrolli në lidhje me ligjshmërinë e emërimeve në Bashkinë Mat, për periudhën 28.04.2017 e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 66, datë 30.03.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017", në të cilin është vendosur:

***1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Mat, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për 10 (dhjetë) punonjësit e mëposhtëm:***

- ✓ *Të anulojë aktin nr. 576, datë 26.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Auditit".*

- ✓ Të anulojë aktin nr. 407, datë 06.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Auditit të Brendshëm”.
  - ✓ Të anulojë aktin, nr. 326, datë 21.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist i Apelit Tatimor”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 404, datë 04.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr.399, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialiste e Buxhetit në Sektorin e Financës”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 402, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normativave të Konsumit në Sektorin e Financës”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 502, datë 12.08.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialiste e Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfëra, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 400, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist i Sektorit të Turizmit, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 376, datë 21.06.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Burrel”.
  - ✓ Të anulojë aktin nr. 398, datë 01.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, në Njësinë Administrative Lis”.
2. Njësia përgjegjëse të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duke e ndarë në dy faza.
  3. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017 planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.
  4. Pozicionet në fjalë, duhen të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.
  5. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset që të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për

*pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*

*Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:*

- ✓ *Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.*
- ✓ *Të bëhen publike në faqen zyrtare “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Mat dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:*
  - a) *Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.*
  - b) *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
  - c) *Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
  - d) *Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*

6. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mat të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen për zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 66, datë 30.03.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017", me Vendimin Nr. 178, datë 27.07.2017, "Për verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 66, datë 30.03.2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017'", ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 66, datë 30.03.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 04.09.2017, u paraqitën pranë institucionit, Bashkia Mat.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetënin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, rezultoi se:

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 1 të Vendimit Nr. 66, datë 30.03.2017, ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Mat të anulojë aktet e emërimit për punonjësit \*\*\*\*\* ("Përgjegjës i Sektorit të Auditit"), \*\*\*\*\* ("Specialiste në Sektorin e Auditit të Brendshëm"), \*\*\*\*\* ("Specialist i Apelit Tatimor"), \*\*\*\*\* ("Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore"), \*\*\*\*\* ("Specialiste e Buxhetit në Sektorin e Financës"), \*\*\*\*\* ("Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normativave të Konsumit në Sektorin e Financës"), \*\*\*\*\* ("Specialiste e Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfra, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike"), \*\*\*\*\* ("Specialist i Sektorit të Turizmit, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik"), \*\*\*\*\* ("Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike, në Njësine Administrative Burrel") dhe \*\*\*\*\* ("Specialist i Kadastrës së Tokës Bujqësore, në Njësine Administrative Lis"), të cilët kanë filluar marrëdhënien e punësimit në kundërshtim me ligjin (nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar,

VKM Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, dhe VKM Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimet në kategorinë ekzekutive”).

Me vendimin Nr. 66, datë 28.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë Mat është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punësimit të punonjësit \*\*\*\*\* për shkak të ligjit, si pasojë e vdekjes së tij.

Gjatë verifikimit në subjekt, u konstatua se 9 punonjësit e tjerë të përmendur më sipër, vazhdonin marrëdhënien e punës në Bashkinë Mat. Nga komunikimi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore u pretendua se për shkak të kohës së shkurtër të lënë në dispozicion, nuk mund të anuloheshin aktet dhe të ndërpritej në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punësimit, pasi do të kishte pasojë për funksionimin normal të punës së institucionit. Nga ana tjetër, kjo njësi ka marrë masat për plotësimin e pozicioneve në fjalë nëpërmjet procedurave të konkurrimit në përputhje me ligjin, në përfundim të të cilave janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin nr. 1856 prot., datë 24.07.2017, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Auditit të Brendshëm”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin nr. 1855 prot., datë 24.07.2017, në pozicionin “Specialist Buxheti në Sektorin e Financës”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin e emërimit nr. 1859 prot., datë 24.07.2017, në pozicionin “Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normativave të Konsumit në Sektorin e Financës”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin e emërimit nr. 1857 prot., datë 24.07.2017, në pozicionin “Specialist Turizmi në Sektorin e Turizmit, Trashëgimisë Historike dhe Arkeologjike, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin e emërimit nr. 1858 prot., datë 24.07.2017, në pozicionin “Specialist i Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfra, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin e emërimit nr. 1518, datë 19.06.2017, në pozicionin “Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, pranë Njësive Administrative”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin nr. 652 prot., datë 17.03.2017, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”.
- ✓ \*\*\*\*\* , emëruar me aktin nr. 1718 prot., datë 10.07.2017, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësive Administrative Burrel”.

Sa më sipër, pavarësisht faktit që nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, Bashkia Mat, nuk janë anuluar aktet e paligjshme të emërimit për punonjësit e sipërpërmendur, duke qenë se tashmë pozicionet e mbajtura prej tyre janë plotësuar në përputhje me ligjin, kjo pikë e vendimit do të konsiderohet

e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj njësie që në të ardhmen të zbatojë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe “Specialist i Apelit Tatimor”, rezultojnë të jetë të lira për shkak të mungesës së kandidatëve. Në përfundim të procesit të konkurrimit dhe plotësimit të këtyre pozicioneve, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin, duke bashkëngjitur edhe aktet që materializojnë zhvillimin e procedurës në përputhje me ligjin dhe rekomandin e Komisionerit në Vendimin Nr. 66, datë 30.03.2017.

- Në zbatim të rekomandimit të lënë në pikën 3 të vendimit të Komisionerit, me aktin nr. extra prot., datë 20.02.2017, “Mbi pranimet në shërbimin civil viti 2017”, Bashkia Mat ka hartuar planin e punës së pranimeve në shërbimin civil për vitin 2017, në përputhje me përcaktimet e Vendimit Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të Këshillit të Ministrave. Nga këqyrja e këtij plani rezulton se në të janë përfshirë të gjitha pozicionet e lira të punës sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin Nr. 70/1, datë 22.07.2016, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë”, si dhe ato që janë zënë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Në pikat 2, 4 dhe 5 të Vendimit Nr. 66, datë 30.03.2017, objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin të shpallen të lira dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, në përputhje me përcaktimet ligjore, duke bërë kujdes për të përmbushur rregullat e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në zbatim të rekomandimit të mësipërm, me shkresën nr. 1100, datë 04.05.2017, të titullarit të institucionit, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, bazuar në nenin 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të Këshillit të Ministrave, është bërë shpallja për plotësimin e 6 pozicioneve të lira të punës, si më poshtë:

- *Specialist i Apelit Tatimor, Bashkia Mat;*
- *Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Mat;*
- *Specialist Buxheti, në Sektorin e Financës;*
- *Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normave të Konsumit në Sektorin e Financës;*
- *Specialist Turizmi në Sektorin e Turizmit, Trashigimisë Historike dhe Arkeologjike;*

- *Specialist i Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfra në Sektorin e Ndhmës Ekonomike.*

Me shkresën nr. 1101 prot., datë 04.05.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, është bërë shpallja për plotësimin e 3 pozicioneve të lira të punës, si më poshtë:

- *Përgjegjës i Sektorit të Financës;*
- *Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm;*
- *Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel.*

Me shkresën nr. 743 prot., datë 29.03.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ndër të tjera, është bërë shpallja për plotësimin e pozicionit të lirë:

- *Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, në Njësinë Administrative Lis.*

Me Urdhrin Nr. 616, datë 10.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë Mat është krijuar “Komiteti i Përhershëm i Pranimit në Kategorinë Ekzekutive” dhe me urdhrat nr. 59, datë 22.02.2017 dhe nr. 285, datë 14.06.2017, është krijuar Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 242, datë 18.05.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18.05.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të Këshillit të Ministrave.

Me shkresat nr. 904 prot., datë 12.04.2017 dhe nr. 1230 prot., datë 17.05.2017, “Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit nga jashtë në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, të Bashkisë Mat është njoftuar Shërbimi Kombëtar i Punësimit se për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionet: *Specialist i Kadastrës së Tokës Bujqësore pranë Njësisë Administrative, Specialist i Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfëra në Sektorin e Ndhmës Ekonomike; Specialist i Apelit Tatimor; Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm; Specialist Buxheti, në Sektorin e Financës; Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normave të Konsumit në Sektorin e Financës; Specialist Turizmi në Sektorin e Turizmit, Trashëgimisë Historike dhe Arkeologjike*, nuk është paraqitur asnjë kandidat dhe, për këtë arsye, këto pozicione do të plotësohen përmes procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Me shkresat nr. 996 prot., datë 24.04.2017, nr. 1406, datë 02.06.2017, nr. 1524/4 prot., datë 19.06.2017, “Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Mat ka njoftuar rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e pranimit në shërbimin civil për pozicionet e mësipërme.

Më tej, me aktet nr. 1686 prot., datë 07.07.2017; nr. 1450/3 prot., datë 12.06.2017; nr. 1774/2 prot., datë 17.07.2017; nr. 1774/3 prot., datë 17.07.2017; nr. 1774/4 prot., datë 17.07.2017 dhe nr. 1774 prot., datë 17.07.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Mat ka njoftuar aktin e shpalljes së kandidatëve fitues me më shumë se 70% të pikëve, për fazën e dytë “pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”.

Në përfundim të procesit janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove punonjësit si më poshtë:

- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1856 prot., datë 24.07.2017, është emëruar në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Auditit të Brendshëm*”.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1855 prot., datë 24.07.2017, është emëruar në pozicionin “*Specialist Buxheti në Sektorin e Financës*”.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin e emërimit nr. 1859 prot., datë 24.07.2017, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Inventarizimit të Aktiveve dhe Normativave të Konsumit në Sektorin e Financës*”.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin e emërimit nr. 1857 prot., datë 24.07.2017, është emëruar në pozicionin “*Specialist Turizmi në Sektorin e Turizmit, Trashëgimisë Historike dhe Arkeologjike, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik*”.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin e emërimit nr. 1858 prot., datë 24.07.2017, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Identifikimit, Mbikëqyrjes dhe Kujdesit për Familjet e Varfra, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike*”.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin e emërimit nr. 1518, datë 19.06.2017 është emëruar në pozicionin “*Specialiste e Kadastrës së Tokës Bujqësore, pranë Njësisë Administrative*”.

Me shkresat nr. 130 prot., datë 20.01.2017 dhe nr. 1229, datë 17.05.2017, “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e lëvizjes paralele*”, Bashkia Mat ka njoftuar Shërbimin Kombëtar të Punësimit se për pozicionet: *Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel*, nuk është paraqitur asnjë kandidat dhe, për këtë arsye, këto pozicione do të plotësohen përmes procedurës së ngritjes në detyrë.

Me shkresat nr. 134 prot., datë 23.01.2017 dhe nr. 1391 prot., datë 01.06.2017, “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Mat ka njoftuar rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionet e mësipërme.

Më tej, me shkresat nr. 655 prot., datë 17.03.2017 dhe nr. 1721 prot., datë 10.07.2017, “*Shpallje fituesi*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Mat ka njoftuar aktin e shpalljes së kandidatëve fitues me më shumë se 70% të pikëve, për fazën e dytë “ngritje në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese”.



Në përfundim të këtij procesi:

- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 652 prot., datë 17.03.2017, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Mat.
- ✓ \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1718 prot., datë 10.07.2017, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë në Njësinë Administrative Burrel”.

Me shkresën nr. 1227 prot., datë 17.05.2017, “Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të Bashkisë Mat është njoftuar Shërbimi Kombëtar i Punësimit se për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, nuk ka asnjë kandidat për procedurën e lëvizjes paralele, prandaj procedura do të vazhdojë me ngritjen në detyrë. Më tej, me shkresën nr. 1450/2 prot., datë 12.06.2017, Bashkia Mat ka njoftuar Shërbimin Kombëtar të Punësimit se për procedurën e ngritjes në detyrë për këtë pozicion nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit.

Me shkresën nr. 1524/3 prot., datë 19.06.2017, të Bashkisë Mat është njoftuar Shërbimi Kombëtar i Punësimit se për procedurën e pranimit në shërbimin civil për pozicionin Specialist i Apelit Tatimor nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vijuar konkurrimin.

Për këtë arsye, pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe “Specialist i Apelit Tatimor”, rezultojnë të jetë të lira. Në përfundim të procedurës për plotësimin e këtyre pozicioneve, Kryetari i Bashkisë Mat dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin, duke bashkëngjitur edhe aktet përkatëse që materializojnë zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për këto 2 raste.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 66, datë 30.03.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Mat janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 66, datë 30.03.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 16, datë 09.02.2017”*, në Bashkinë Mat.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Mat, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 66, datë 30.03.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Mat dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**